



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 948/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës së Shtimes, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 21.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e palejuar ankesa e Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës të Shtimes.

Arsyetim

PZAP, me datën 20.11.2013, ka pranuar ankesë nga Isuf Musliu kandidat i pavarur për kryetar të komunës të Shtimes, në të cilën ankesë theksohet se nuk i pranon zgjedhjet e 3 Nëntorit 2013, për arsye se në të gjitha vendvotimet nuk iu është caktuar komisionerë as vëzhgues, nga KQZ-ja, votuesve nuk iu është lejuar fotografimi i votës, parashtruesi thekson se ka dëshmi për 5200 nënshkrime të pavarura të cilët e kanë dëshmuar vullnetin tyre pa kurrfarë imponimi, dhe se i ka të gjitha nënshkrimet e votuesve, po ashtu thekson se janë bërë manipulime të vullneteve të shprehura, si dhe parashtruesi i ankesë kërkon të bëhet rivotimi ose sqarimi nga KQZ-ja, Prokuroria e Shtetit dhe Drejtësia, si dhe të merren hetime edhe ndaj organizatorët dhe përkrahësve kinse siç thotë të tij. Parashtruesi i ankesës shpall veten fitues në bazë të dëshmive të votuesve dhe kërkon që të ndëshkohen para drejtësisë të gjithë manipuluesit e votave, si dhe lidhur me këto thekson se ka kontaktuar me Prokurorinë e shtetit, reshterë dhe kapiten.

PZAP-i, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, të datës 18.11.2013, Anr.887/2013. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 948/2013 më datën 21.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**





Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.